



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e IX-të (nëntë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 22 mars 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10:30.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, dhe znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe znj.Adelinë Stublla Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK-Podujevë, dhe përfaqësues të KFOR-it.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 23.02.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 23 shkurt 2023

2. Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për gjendjen socio-ekonomike të Komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, prezent kemi edhe Drejtoreshën e DSHMS e cila besoj se do të paraqet një informatë të shkurtër rreth kësaj pike të rendit të ditës, andaj urdhëroni Drejtoresh e nderuar, fjala për ju.

znj.Adelinë Stublla, Drejtoreshë e DSHMS-së, e paraqiti informatë rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, po e paraqes këtë informatë për muajt janar, shkurt, mars, 2023, rreth gjendjes sociale- ekonomike, të Komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Gjatë këtyre muajve Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me mjete financiare ka ndihmuar 4 familje të komuniteteve jo shumë në vlerë prej 1,400.00€, nga mjetet vetanake, rastet tjera të cilat kanë aplikuar për subvencione për barna janë në shqyrtim e sipër.

Në bashkëpunim me donatorët janë ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike 31 familje, janë ndihmuar dy familje me lëndë djegëse, një familje është ndihmuar me stufë, kemi identifikuar të cilat do të përfshihen në donacionet e radhës, kërkesat për veshmbathje dhe miell janë adresuar te Kryqi i Kuq i cili është përgjigjur pozitivisht. Rastet që janë në prioritet për banim janë identifikuar dhe janë në pritje të buxhetit apo pritjes nga donatorët, kurse në aspektet shëndetësore është kryer vaksinimi i rregullt i fëmijëve nga komuniteti jo shumicë ku gjatë muajve janar –mars 2023, janë telefonuar, janë bërë ftesa dhe ekipet e vaksinimit kanë dalë në terren ku gjatë muajve janar –mars 2023, janë vaksinuar 20 fëmijë dhe 30 nxënës.

Sa i përket asistencës sociale nga komuniteti rom janë 5 familje me 30 anëtar që përbëjnë 6.68% të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, nga komuniteti ashkali kemi 67 anëtar që i bie 8.74%, vlen të theksohet rasti i strehimit të familjes që ka jetuar me vite të tëra në baraka afër stacionit të trenit në gjendje tepër të vështirë, tani anëtarët e kësaj familje janë tepër të kënaqur që i kemi strehuar në njërën prej shtëpive në lagjen e dëshmorëve. Ne si drejtori i vizitojmë çdo herë familjet e komunitetit jo shumicë në terren dhe kujdesemi për ta brenda mundësive ligjore si në aspektin shëndetësor ashtu edhe për gjendjen sociale, ekonomike dhe atë të strehimit, ne së bashku jemi duke u përpjekur për të ndërtuar një të ardhme gjithëpërfshirëse me mundësi më të mëdha për secilin/e, me mundësi të barabarta për të gjithë pa dallim për një shoqëri të drejtë përparimtare për një mirëqenie të barabartë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e falënderoj drejtoreshën e DSHMS-së për punën e bërë në dobi të komuniteteve jo shumicë në komunën e Podujevës të cilët marrin ndihmë sociale dhe të tjera.

znj.Sevdie Rama, theksoi, e falënderoj drejtoreshën e DSHMS-së, për punën që është duke e bërë dhe i dëshiroj suksese se është duke e bërë një punë të pa lodhshme.

znj.Adelinë Stublla, Drejtoreshë e DSHMS-së, falënderoi parafolësin për vlerësimin e bërë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, faleminderit znj.Sevdiye për vlerësimin tuaj nëse dikush ka për të thënë diçka ose ndonjë pyetje për këto statistika që i ceku drejtoresha të cilat janë reale që komuniteti rom, ashkali, egjiptian i gëzon në Komunën e Podujevës, me gjitha ato peripteri që i takojnë një komuniteti pa dallime në strukturat tjera, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e konstatojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Raporti i punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2022

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, e paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, ne si ZKK kemi pas dy informata të cilat i kemi paraqit, informata e parë ka qenë për periudhën kohore janar-qershor 2022, dhe informata e dytë qershor- dhjetor 2022, koordinimi i ZKK-së, dihet se është një koordinim i jashtëzakonshëm me qeverisjen lokale dhe me nivelin qendror dhe njëkohësisht edhe me OJQ-të qoftë ato vendore apo ndërkombëtare, që kemi një përkrahje dhe një bashkëpunim të sinqertë për integrimin, ndihmën, gjendjen socio- ekonomike të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës. Shpesh herë e kam thënë se termi komunitete jo shumicë nuk është term i duhur dhe se ne nuk kemi dallime prandaj do të thoja se i kemi bashkëqytetar dhe të gjitha të mirat gjithmonë i ndajmë së bashku si institucion prandaj edhe kemi arritur rezultate të mira sa i përket bashkëpunimit me komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Unë shpreh një respekt të veçantë për drejtoreshën e DSHMS-së, që na e dha një informacion mjaftë të mirë për kontributin dhe angazhimin e saj për punët dhe angazhimet e tyre si drejtori kur dihet se DSHMS-ja është një nga drejtoritë specifike që merret me shëndetësi, mirëqenie

sociale, strehim dhe banim, prandaj kjo drejtori është njëra nga drejtoritë që paraqet shtyllat kryesore të këtyre rrethanave. Sa i përket personave të riatdhesuar nga radhët e komuniteteve në të gjitha dokumentacionet ua plotësojmë duke filluar nga strategjia 2022-2026, planin e veprimit në nivelin nacional si dhe atë të nivelit komunal, çdo komunë i ka specifikat e saj, duke u bazuar në dokumentacionin si dhe në udhëzime dhe rregulloret në normalisht që nga koha e qeverive të kaluara e deri më tani për personat e riatdhesuar kemi një bashkëpunim me Unionin Evropian për ofrimin e gjitha shërbimeve si ato për emergjenca, strehim, shëndetësi, biznes. Shtyllat kryesore që ne jemi fokusuar që janë nga strategjia dhe plani zhvillimor janë, arsimit, shëndetësia, punësimi, mirëqenia sociale, banimi, infrastruktura, mediat, kultura, rinia, sporti, mirëpo në gjitha ato dokumente përshkruhet edhe termi diskriminim e këtë për Komunën e Podujevës mund të them se ky term mund të përdoret vetëm si diskriminim pozitiv sepse nuk kemi diskriminim negativ për këto vitet e pas luftës, besoj se edhe në të ardhmen në Komunën e Podujevës nuk do të kemi diskriminim negativ, mirëpo këtë term nga dokumentet nuk mund ta largojmë sepse janë organet dhe zyrtarët përgjegjës që merren me këtë çështje sepse diskriminimi nuk e ka kuptimin vetëm të komunitetet jo shumicë por edhe të komuniteti shumicë sa i përket punësimit, shëndetësisë, arsimit.

Sa i përket komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës mendojmë se nuk kemi ndonjë lloj të diskriminimit, sa i përket fushës së arsimit e falënderoj shumë z.Xhafer Ademi që është munduar jashtëzakonisht shumë për arsimimin e nxënësve të komuniteteve jo shumicë sepse kohë më parë kemi pas një numër mjaft të vogël të këtyre nxënësve kurse sot ne mund të mburremi se i kemi 192 nxënës në shkollat fillore dhe të mesme mirëpo ky numër i nxënësve duhet të rritet dhe asnjë nxënës mos të jetë jashtë bankave shkollore, prej këtyre nxënësve 165 janë në SHFMU, dhe 27 nxënës janë në SHMLT, te numri i studentëve kemi çaluar e arsytet dihen se janë ato socio- ekonomike. Ne jemi munduar edhe me shoqata të ndryshme qoftë vendore dhe ndërkombëtare si dhe me donator të ndryshëm që t'i stimulojmë që këta nxënës t'i fillojnë studimet sepse ne do t'ju ndihmojmë edhe me bursa sepse të gjithë ne po e shohim gjendjen ekonomiko – sociale në të cilën po jetojmë e që po na preukupon ikja e të rinjve nga vendi për një jetë më të mirë por ne si Komunë por edhe në nivelin qendror duhet të bëjmë më shumë për këto kategori. Duke e falënderuar Kryesuesin e Komitetit si dhe shoqatat tjera të ndryshme që kemi arritur të mbajmë edhe orë shtesë mësimore me organizatën Zëri i ashkalinjëve, romëve dhe egjiptianëve dhe ne si ZKK çdo herë ju kemi ndihmuar që nxënësit dhe studentët të aplikojnë për bursa dhe në këtë mënyrë ne t'i përkrahim sa do pak për vijim e mësimin. Sa i përket shëndetësisë për këtë na u dhanë sqarime nga drejtoresha e DSHMS-së, andaj ju them se kemi një infrastrukturë të mirë shëndetësore duke filluar prej QKMF-së, AMFV-ve, në fshatrat Kërpimeh, Lluzhan dhe Orllan, personeli shëndetësor është jashtëzakonisht profesional në aspektin e mjekësisë primare pa dallime prandaj e them se betimi i mjekut është betimi më i sigurtë që t'i dalë në ndihmë secilit. Ne si ZKK kemi dhënë informacione për rëndësinë e vaksinimit së bashku me DKA-në, për ta ruajtur këtë rini të shëndetshme që e kemi duke i informuar me dukuritë negative të lëndëve narkotike, duhanit dhe pijeve alkoolike me të vetmin qëllim ruajtjen e shëndetit të fëmijëve tanë.

Sa i përket punësimit dhe mirëqenies sociale dihet se punësimi çdo herë ka qenë në shkallë jo të kënaqshme dhe shqetësimin im është se të rinjtë e komunitetit duhet të punojnë edhe në ndërmarrjet private sepse shumë njerëz kanë zanate të ndryshme dhe mund të involvohen dhe të punojnë. Sa i përket sektorit publik është një koordinim dhe bashkëpunim i mirë dhe i sigurtë i dy anshëm sepse në Komunën tonë kemi 27 persona janë të punësuar nga komuniteti jo shumicë, në FSK janë 3 të punësuar, q person është i punësuar në KEDS, në Polici janë të punësuar 2

persona, në arsim janë të punësuar 4 persona, një person është i punësuar në shërbim të zjarrfikësve, në shëndetësi është i punësuar 1 person, në kompaninë e pastrimit janë të punësuar 7 punëtor, në Komunë është i punësuar 1 person, në Kosova trans është i punësuar 1 person si dhe persona tjerë të punësuar si teknik në shkolla të komunës tonë, por numerikisht kur e marrim këtë shifër të të punësuarave ne jemi të pa kënaqur. Duke u bazuar në statistikat e entit të punësimit çalojnë shifrat e kjo është normale sepse vitin e kaluar 31 persona të dy gjinive kanë kërkuar punë dhe në bazë të mundësive eventuale ne do t'ju ofrojmë ndihmë por tani janë të hapura edhe konkurset për vende të punës por më së shumti duhet t'i japim rëndësi sektorit privat që të kemi një qëndrueshmëri më të madhe ekonomike e për këtë kontribut në komunën tonë kanë dhënë edhe OJQ-të siç është OJQ Qëndrimi, OJQ Shpresa Demokratike që çdo herë kemi bashkëpunuar andaj i falënderoj.

Ne e dimë se në QPS është një numër jashtëzakonisht i madh i familjeve që marrin ndihmë e prej tyre janë 72 familje të komunitetit ashkalinjë marrin ndihmë sociale, 5 familje të komunitetit rom, e që gjithsej janë 432 anëtar të këtyre familjeve në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale, por ka familje të cilat nuk janë në gjendje të mirë ekonomiko-sociale e nuk përfitojnë ndihmë për shkak të kriterëve të përcaktuara nga ministria e këtë çdo herë duhet ta kemi para sysh si komunë dhe t'i verifikojmë gjitha ato familje dhe t'ju dalim në ndihmë. Sa i përket DSHMS-së, vitin e kaluar ka ndarë subvencione ku janë ndihmuar 24 familje në shumë 3000€, janë ndihmuar 208 familje me pako ushqimore dhe higjienike si dhe me lëndë djegëse, kurse sa i përket infrastrukturës mund të themi se është në gjendje të mirë dhe në zhvillim e sipër dhe nga anëtarët e komunitetit jo shumicë kemi pasur 3 kërkesa të cilat i kemi dërguar në nivelin qendror e besojmë se ata do të reflektojnë pozitivisht dhe do të na ndihmojnë për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në lagjen "Ali Ajeti", rregullimin e rrjetit të kanalizimit, si dhe rregullimin e një rrugice në lagjen "Xhafer Meta", si dhe rregullimin e një trotuari në këtë lagje, gjithashtu kemi edhe një problem në fshatin Orllan sa i përket rregullimit të rrjetit të ujësjellësit dhe atij të kanalizimit. Sa i përket strehimit mund të themi se është çështje më delikate ashtu siç e theksoi edhe drejtoresha e DSHMS-së, e dihet se problemi më i madh është për legalizimin e pronave e ne e kemi këtë problem edhe nëse vjen ndonjë donator i mundshëm por ne jemi në mundim e sipër që të gjejmë ndonjë pronë dhe ta rregullojmë çështjen e strehimit se është çështja më e ndjeshme sepse nuk mund të ndërtohet shtëpi pa pasur pronën.

Në Podujevë jetojnë 143 familje me 922 banorë shumica absolute e tyre i përkasin komunitetit ashkali që janë 842 banorë si dhe 3 familje të komunitetit rom, ne kemi bashkëpunim jashtëzakonisht kemi bashkëpunim të mirë me OJQ YOM që kemi punuar shumë për punësimin e anëtarëve të komunitetit jo shumicë dhe jemi në vazhdim e sipër me shumë institucione për punësimin e të rinjve. Sa i përket mediave, kulturës rinisë dhe sportit është normale që t'i falënderojmë për punën e bërë në bashkëpunim me Komunën dhe OJQ-të e ndryshme dhe për këtë e falënderojmë edhe DKRS-në, për organizimet e shumta kulturore e në veçanti për shënimin e datës 8 prill dhe datës 15 shkurt që janë festa të komuniteteve jo shumicë në komunën tonë. Aktivitetet sportive tashmë janë të hapura dhe secili talent qoftë në muzikë sporte të ndryshme jemi munduar që t'ju ndihmojmë me gjitha mundësitë. Ne si ZKK çdo herë kemi dhënë kontributin tonë për ruajtjen diversitetin dhe pasurimin e gjithë qytetarëve të komunës tonë e sidomos të atyre të komuniteteve jo shumicë, njëkohësisht i falënderoj edhe anëtarët e kuvendit që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për mbështetje të këtyre komuniteteve.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, i nderuar z.Liman Zeqiri ju falënderoj për punën e juaj dhe për gjitha këto statistika që i prezantuat sepse të gjitha shifrat e të punësuarve ne i marrim në zyrën tuaj dhe jeni një njeri i jashtëzakonshëm sepse i gjithë komuniteti për të gjitha problemet adresohen në zyrën tuaj, për të gjitha shërbimet që ata kanë nevojë prandaj ju falënderoj shumë.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, po ndërlidhem sa i përket temës së punësimit që u cek se janë të punësuar 27 anëtar të komunitetit jo shumicë në institucione të ndryshme publike mirëpo në sektorin privat nga komunitetet jo shumicë nuk ka asnjë person të punësuar prandaj dua ta di se a është diskriminim pozitiv apo diskriminim negativ ky fakt edhe përkundër faktit se në sektorin privat ka pas gjithherë të interesuar për punësim, andaj nga ana e juaj pres një mendim.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, unë më parë e ceka se ne duhet të kemi një koordinim dhe ju thash se ne i përfaqësojmë institucionet publike e jo ato private, ZKK ka jashtëzakonisht një koordinim të mirë me organet e qeverisjes lokale, në qoftë se ka ndonjë diskriminim në kuadër institucional qoftë të nivelit lokal ose qendror de fakto ose de juro është një çështje problematike, kurse sa i përket sektorit privat është një çështje më e komplikuar dhe më e ndjeshme dhe këtu çalojmë ne sepse nuk kemi të drejtë ne të ndërhyjmë në këtë sektor por vetëm mund të koordinojmë me punë për të mirën e qytetarëve dhe mundësisht për punësimin e komuniteteve jo shumicë që kanë nevojë por prapë këtu vendosin pronarët e kompanive private dhe ne këtu nuk kemi fuqi ligjore që të ndikojmë në sektorin privat. Unë e ceka edhe më lartë që është mirë që edhe sektori privat të merret me këtë çështje sepse rinia po ik jashtë vendi dhe është mirë që edhe ne si institucion të merremi me këtë problematikë që kompanitë e mëdha private ta kenë parasysh këtë çështje sepse është në të mirën e qytetarëve, por nuk mund të flas për sektorin privat se nuk jam i thirrur të flas për këtë.

z.Florent Hasani, theksoi, është shqetësuese që ndodh ky diskriminim jo vetëm në komunën tonë por edhe në tërë territorin e Republikës së Kosovës andaj propozoj që të shihen mundësitë për një takim me pronarët e sektorit privat dhe thjeshtë si rekomandim t'ju jepet përfshirja e këtyre komuniteteve në vende të punës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë po e potencoj atë që e ceku z. Liman Zeqiri, se në kompanitë private në Komunën e Podujevës ka shumë pak të punësuar edhe pse kanë konkurruar një numër i madh i të rinjve dhe nuk janë pranuar në punë, ashtu siç e ceku parafolësi ne nuk mund t'i dirigjojmë ata që t'i punësojnë këta të rinjë sepse është në kompetencën e tyre por besoj se në të ardhmen këto gjëra do të ndryshojnë.

4. Të ndryshme

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

**Procesverbalin e mbajti
Osman Bajrami**

**Nr.prot.01-060/01-0021575/23
Podujevë, 22 mars 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit
Xhafer Ademi**